



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët në mbarë botën tdh.ch



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Save the Children

Plani Lokal për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është përgatitur nga shoqata ALPIN në bashkëpunim me Bashkinë Tropoje në kuadër të projektit “Ngritja e kapaciteteve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”. Ky botim publikohet me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Save the Children dhe Terre des Hommes. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e shoqatës ALPIN dhe në asnjë rast nuk reflekton qëndrimin e Bashkimit Evropian.



Plani Lokal për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Bashkia Tropojë 2018 - 2021

1. Përmbledhje ekzekutive

Bashkia e Tropojës është një ndër bashkitë e para që ka pilotuar një sërë projektesh që në fokusin e tyre kanë pasur përmirësimin e respektimit të drejtave të fëmijëve. Kështu që nga viti 2003 e në vazhdim ka pasur iniciativa të rëndësishme me ndikim në politikat për fëmijët dhe zbatimin e të drejtave të tyre siç kanë qenë: ngritja e Njesisë për Monitorimin e të Drejtave të Fëmijëve brenda Qarkut Kukës, e cila është pajisur me mjete dhe logjistikë nga UNICEF. Kjo zyre ka raportuar periodikisht për gjendjen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në qark. Duke i paraprirë edhe miratimit të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve qarku Kukës sërish ka pilotuar projektin për Zyrën për Mbrojtjen e Fëmijëve (ZMDF) në Bashkinë Tropojë e cila është ngritur brenda strukturës administrative të shërbimeve sociale të bashkisë Tropojë në vitin 2007 si projekt pilot i financuar nga UNICEF, mbi bazën e te cilës është shtrirë në qarqet tjera të Shqipërisë. Në vitin 2009 me mbështetjen e UNICEF ajo është ri-dimensionuar në Njësinë për mbrojtjen e fëmijës dhe familjes. Kjo për faktin se gjatë punës në terren ka rezultuar që familja ka rol shumë të madh për edukimin e fëmijëve dhe nuk mund të trajtohet e shkëputur. Një pjesë e problemeve të fëmijëve rrjedhin nga paqëndrueshmëria e familjeve, dhuna që gjenerohet në familje si rezultat i varfërisë dhe mungese se burimeve për mbajtjen e familjes. Po kështu gjatë kësaj periudhe ka pasur disa nisma institucionale dhe strukturore në zbatim të drejtave të fëmijëve në përgjithësi në Bashkinë e Tropojës dhe në njësi vendore të veçanta. Duke qenë një zonë kufitare Bashkia e Tropojës ka qenë në qendër të projekteve të njëpasnjëshme dhe thirrjeve për projekt propozime jo vetëm në fushën e zhvillimit turistik apo ekonomik por edhe në fokusin e përmirësimit të drejtave të fëmijës.

Të gjitha këto iniciativa kanë bërë që të kemi një përmirësim të ndjeshëm në realizimin e të drejtave të fëmijëve. Bashkia e Tropojës gjithashtu do të vazhdojë të rrijë e angazhuar për përmbushjen e objektivave të vendosur në kuadër të zbatimit të konventave ndërkombëtare, strategjive kombëtare dhe lokale duke fuqizuar më tej strukturat lokale si Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në Bashki dhe Njësine për Mbrojtjen e Fëmijëve NJMF, në bashki dhe njësi administrative. Ky plan veprimi përcakton prioritetet dhe nevojat që kanë fëmijët e Bashkisë Tropojë për ndërhyrje konkrete duke u bazuar në ligjin nr 18/2017 “Për Të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe dokumente të tjerë strategjikë dhe është hartuar në përputhje edhe me modelin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencisë Kombëtare për Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Dokumentet strategjikë ku është mbështetur hartimi i planit:

- Ligji Nr.18/2017 “Për Të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020
- Ligji nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Strategjia për të drejtat e fëmijëve 2016-2021 Këshilli i Evropës:

Qëllimi:

Ky Plan Lokal për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ka si qëllim ngritjen dhe fuqizimin e mekanizmave përkatës për garantimin e mbrojtjes së drejtave të fëmijëve dhe menyrat për të garantuar ato nepermjet qëllimit kryesor si:

- Qëllimi 1: Zhvillimi i sigurimit të arsimit cilësor për të gjithë fëmijët.
- Qëllimi 2: E drejta e mbrojtjes shoqërore dhe pjesëmarrjes/Integrimi i fëmijëve në
- Qëllimi 3: E drejta e mbijetesës dhe kujdesit shëndetësor
- Qëllimi 4: Mbrojtja e fëmijëve në konflikt me ligjin
- Qëllimi 5: Ngritja/zhvillimi i strukturave të mbrojtjes së fëmijëve
- Qëllimi 6: Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese dhe ngritja e shërbimeve të reja për mbrojtjen e fëmijëve
- Qëllimi 7: Ndërgjegjësimi institucional e komunitar për mbrojtjen e fëmijëve
- Qëllimi 8: Rritja e kapaciteteve organizative të bashkisë për sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve

Objektivat:

- Zbatimi i rolit dhe detyrave të shërbimeve shoqërore në Bashkinë Tropoje dhe specifikisht, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në përputhje me ligjin e ri 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
- Ngritja e kapaciteteve institucionale të Bashkisë Tropojës në përputhje me ligjin e ri 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" dhe funksionimit të grupit ndër sektorial.
- Monitorimi i zbatimit të ligjit të ri Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", sigurimi i mundësive të barabarta dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së fëmijëve për të drejtave të fëmijëve në kuadrin e planit kombëtar të veprimit për fëmijë.
- Përmirësimin e sistemit arsimor për tu bërë i aftë për të siguruar fëmijëve një arsim gjithëpërfshirës
- Përmirësimi i infrastruktures për fëmijët mbi bazën e nevojave lokale dhe standardeve kombëtare duke marrë parasysh edhe grupet në nevojë si PAK.
- Marrja e masave të veçanta lokale nga institucionet përgjegjëse për të luftuar punën e detyruar të fëmijëve dhe gjitha format e shfrytëzimit të fëmijëve.
- Mbështetja me fonde të buxhetit të shtetit duke i planifikuar qysh në projekt buxhetet vjetore.

2. Metodologjia

Përgatitja e këtij Plani Veprimi është bërë me përfshirjen e të gjithë aktorëve në nivel lokal të cilët punojnë për të drejtat e fëmijëve dhe që kanë qenë të përfshirë në zbatimin e Strategjive të ndryshme kombëtare. Ky plan është hartuar në bashkëpunim me të gjithë aktorët që punojnë në nivel vendor për përmirësimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe përfaqësojnë institucione të lidhura ngushtë me të drejtat e fëmijëve si arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale dhe shoqëria civile.

Procesi i hartimit të planit të veprimit është koordinuar nga Shoqata "ALPIN" Tropojë, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Save the Children në Shqipëri dhe Terre des hommes në Shqipëri.

Për të mos mbivendosur dokumente strategjike është vendosur që ky plan veprimi të bashkëngjitet Planit Social të Bashkisë.

Metodologjia e hartimit të këtij plani veprimi konsiston në:

- Analizën e situatës së të drejtave të fëmijëve në Tropojë duke zhvilluar intervista me fokus grupe me profesioniste.
- Analizën e politikave, dokumenteve, strategjive dhe vlerësimeve bashkëkohore mbi fëmijët dhe të drejtat e tyre
- Analizën e Planit Kombëtar të Veprimit për Fëmijët.
- Organizimin e tryezave të rrumbullakëta për diskutimin e problemeve të fëmijëve me pjesëmarrje të institucioneve kryesore të Bashkisë përfshi edhe shoqërinë civile që ka për objekt të punës së vet fëmijët

3. Analiza e gjendjes aktuale:

Bashkia e Tropojës ka një popullsi prej rreth 28.230 banorësh, 9306 familje me 8 Njësi Administrative nga të cilat 1 urbane dhe 7 rurale sipas ndarjes së re territoriale dhe 1/3 e kësaj popullsie janë fëmijë. Në 2016 struktura moshore e popullsisë së Bashkisë Tropoje tregon se 29% e popullsisë i takon grup moshës 0-14 vjeç, 64,5 % grup moshës 15-64 vjeç dhe 6,5 % 65 vjeç e sipër. Femrat përbëjnë 49 %. Pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve jetojnë në zonat rurale e në kushte të pa favorshme për edukim, arsimim, marrje të shërbimit shëndetësor. Ka mangësi të shërbimeve konkrete që janë të orientuara kryesisht në mbrojtjen e fëmijëve. Mangësi të kapaciteteve profesionale në mbrojtjen e fëmijëve sidomos në njësitet e reja administrative. Mangësi ka në njohjen e ligjit 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" mbrojtjen e fëmijëve nga ana e institucioneve të ngarkuara për zbatimin e këtij ligji.

Situata e shërbimeve Sociale në Bashkinë Tropoje për fëmijët në nevojë është për të dëshiruar, situatë e cila shpjegohet edhe me shifra në tabelat e mëposhtme. Gjithashtu bashkia Tropoje duke qenë në strukturimin e saj sipas ligjit Nr. 139/2015 "Për vet qeverisjen vendore "pasqyrat e shërbimeve

sociale janë të pa plotësuar dhe të cinguar. Ndaj me ngritjen e zyres për mbrojtjen e fëmijëve pranë Bashkisë Tropoje sfida për cilësinë dhe shërbimet sociale për mbrojtjen e drejtave të fëmijëve do të qasë ndryshe. Me miratimin e planit lokal të veprimit për mbrojtjen e drejtave të fëmijëve në Tropoje, zyra e ngritur pranë Bashkisë do të përdoret në shërbim të punës së saj.

3.1. E drejta e mbrojtjes shoqërore

Në Bashkinë Tropoje mbështeten me ndihmë mujore mesatare prej 4,315 lekësh në muaj rreth 2366 familje ose 39.3 % e familjeve që jetojnë në këtë bashki.

% i familjeve të varfra me fëmijë	56 %
Familjet me një anëtar me aftësi të kufizuara përbëjnë	11
Familje të drejtuara nga gra	3.4 %
Fëmijë me aftësi të kufizuara	125
fëmijë të abuzuar situatë rrugë	4
Fëmijët e moshës 0-18 vjeç	30.5 %
Niveli i papunësisë	50% të forcave të afta për punë

Niveli i papunësisë në Bashkinë Tropoje është shumë i lartë. Të dhënat e censusit 2011 tregojnë një nivel papunësie në masën 40%. Papunësia është më e lartë tek të rinjtë me një nivel prej 66%. Pjesa më e madhe e popullsisë është e punësuar në sektorët e tregtisë dhe shërbimeve (57.3%) ndërsa rreth 33% në sektorin e bujqësisë dhe vetëm 9.5% në sektorin e industrisë. 51.6% e personave që punojnë janë të punësuar tek të tretët, ndërsa 48.4% janë të vetë-punësuar ose punojnë në bizneset familjare.

Grupet e marginalizuara: fëmijë nga familjet të varfëra, një përqindje e konsiderueshme e të rinjve të papunë, problemet sociale në familje ku paraqiten gra me histori dhune në familje apo preh të trafikimit, persona me aftësi të kufizuara dhe të moshuar të vetmuar etj.

Reformat e ndërmarra nga qeveria gjatë periudhës 2013-2017 nuk kanë sjellë ndryshimet e pritshme ekonomike. Karakteristikë tipike është lulëzimi i basteve sportive. Në fund të vitit 2017 janë shtuar lojërat e fatit vetëm në qytetin e B.Currit. Në Tropoje në vitin 2012 kishte 1 pikë të lojërave të fatit, tani numërohen 15 vetëm në qytetin e Tropojës. Të gjitha pikat e lojërave të fatit nuk zbatohen ligjin për moslejimin e fëmijëve nën 18 dhe nuk afishojnë tabela për fëmijët. I njëjti problem po shtrihet tashmë edhe nëpër fshatra dhe frekuentohen nga fëmijët. Një tjetër fenomen shqetësues i shfaqur së fundmi është edhe rritja e numrit të nxënësve të shkollave të mesme kryesisht të qytetit që përdorin drogën të lehtë. Edhe pse akoma nuk ka një vlerësim të situatës të dhënat nga terreni dhe nga perceptimet e mësuesve tregojnë për një rritje shumë të shpejtë të këtij fenomeni. Mësuesit pohojnë se ky fenomen po bëhet gjithnjë më shqetësues si për procesin mësimor edukativ ashtu edhe për shëndetin e nxënësve po ashtu ky shqetësim vjen dhe nga personeli shëndetsor.

Të marra nga ku? Ndoshta mënyra sesi mund t'i referohemi është "Edhe pse akoma nuk ka një vlerësim të situatës të dhënat nga terreni dhe nga perceptimet e mësuesve tregojnë për një rritje shumë të shpejtë të këtij fenomeni".

3.2 E drejta për arsim

Për periudhën në shqyrtim, gjendja e të drejtave të fëmijëve në Bashkinë e Tropojës po verëhet ndryshimi. Në nivel qarku janë zbatuar një sërë projektesh, që e kanë renditur Tropojën ndër prodhuesit e modeleve që po zbatohen në nivel kombëtar: Projektet për zbatimin e braktisjes së fshehtë, që u vijnë në ndihmë fëmijëve me vështirësi në të nxënë janë zbatuar me sukses, si nga DAR Kukës, me mbështetjen e UNICEF-it, ashtu edhe nga organizata të tjera si "Partner për fëmijët", me mbështetjen e Komisionit Evropian, duke ulur numrin e nxënësve me vështirësi në të nxënë. Në kuadrin e zbatimit të këtyre projekteve, vëmendja është fokusuar në vlerësimin e hapave të ndërmarra në shkollat në zbatim të udhëzimeve të MAS-it për reduktimin e braktisjes së fshehtë dhe në hartimin e rekomandimeve për përshtatësimin e qasjes së kësaj dukurie në punën e shkollave dhe të drejtorive të tyre, si dhe në organizimin e kurseve mësimdhënëse me mbi 100 nxënës në nevojë, kryesisht në

zonat rurale. Në zbatim të projektit madhor të MAS-it për uljen në zero të braktisjes fizike të shkollës nga fëmijët, në bazë edhe të rekomandimeve të studimit të kryer nga DAR Kukës për këtë dukuri, janë hartuar dhe po zbatohen plane veprimi për shkollat dhe DAR-in për uljen e saj. Rritja e kontributit të prindërve në edukimin e fëmijëve po bëhet jo vetëm nëpërmjet organizmave prindërore në shkollë, por edhe organizmave prindërore koordinuese si Bordi Rajonal Këshillimor i Prindërve pranë DAR-it dhe Këshilli Rajonal i Arsimit pranë Qarkut Kukës, të cilat kanë intensifikuar veprimtarinë e nëpërmjet zbatimit të projekteve të mbështetura nga UNICEF-i.

Me gjithë punën e bërë, problematika e të drejtave të fëmijëve në Bashkinë Tropoje ende është e ngarkuar me mosrealizime, të cilat ndikojnë në formimin e përgjithshëm të tyre dhe në pajisjen me aftësitë e nevojshme për të përballuar arsimimin e mëtejshëm dhe përshtatjen në tregun e punës.

Problemi kryesor në plotësimin e të drejtave të fëmijëve në edukim në Bashkinë Tropoje është **cilësia ende e dobët e shërbimit arsimor**, e parë kjo si në aspektin e aksesit që siguron sistemi për të gjithë fëmijët, ashtu edhe për cilësinë e produktit arsimor.

Nr i fëmijëve 3-6 vjeç tërhiqen në kopshte	130 fëmijë
Nxënësit e klasës së parë kanë ndjekur kopshtin.	120 nxënës
% e fëmijëve 6-vjeçare që janë regjistruar në klase të parë	220 nxënës
Nr i nxënësve që nuk plotësojnë objektivat minimale të të nxënë	9 %.
Nr i nxënësve që përdorin alkool, duhan dhe narkotikë.	1 %
Nr i drejtuesve të shkollave të kenë marrë kualifikimin përkatës dhe të jenë përzgjedhur me konkurs.	17
Nr i mësuesve të pakualifikuar në shkollat e Tropojë	8%
Nr i shkollave me klasa kolektive,	44 shkolla bashke me shkollat vartëse
Nr i klasave dhe nr i nxënësve në këto klasa	82 klasa 629 nxënës
Nr i shkollova të rikonstruktura	Per 2017 1 shkolla
Nr i kompjuterëve për shkollë	2 kompjuter/për shkollë
Nr i shkollave të kenë palestër/kënd sporti	5 shkolla me palestra
Nr i fëmijëve me nevoja të veçanta tërhiqen në shkollë	23 fëmijë

Zonat rurale janë më të zbuluara për nga shtrirja e shërbimit të arsimit parashkollor. Në harkun kohor të pesë vjetëve numri i fëmijëve në kopshte është rritur. Një ndihmesë për përfshirjen e fëmijëve 3-6 vjeç në edukimin parashkollor ka luajtur edhe shoqata “Partnerë për Fëmijë” e cila ka zbatuar disa projekte në Bashkinë Tropoje.

Gjithashtu përmirësime ka në numrin e nxënësve të klasës së parë që kanë ndjekur kopshtin të paktën një vit, përqindja e të cilëve ka arritur në 85 %, nga 56% që ishte dhjetë vite më parë, në vitin 2016. Përmirësime ka në aplikimin e metodologjive të përparuara të mësimdhënies e edukimit në këtë nivel të arsimit, si zbatimi i standarteve dhe metodologjia “Hap pas hapi”, që kanë mundur përparimin e fëmijëve në zotërimin e koncepteve bazë për moshën si dhe në aftësitë për jetë sociale, sidomos në qytete.

Vitin e kaluar kemi 235 nxënës që janë regjistruar në klasë të parë. Në shifra zyrtare analfabetizmi është në masën 0 %, por gjatë kontakteve në terren me mësues dhe nxënës rezulton që kjo shifër të shkojë deri në 5 %. Kjo vjen si rezultat i neglizhences së punës së aktoreve në këto procese. Nxënës të shkollave të mesme në fshatra shfaqin më shumë këto probleme.

Numri i nxënësve që nuk plotësojnë objektivat minimale shkon në 10 % nga statistikat zyrtare nga drejtoria rajonale e arsimit në Kukës.

Ka lëvizje pozitive për përfshirjen e prindërve në edukim, sidomos në shkollat e qyteteve, si rrjedhojë e zbatimit të një projekti nga ZA Tropoje, me mbështetjen e Bashkimit Evropian.

Me gjithë investimet e bëra për përmirësimin e infrastrukturës shkollore, ende ka probleme të cilat vështirojnë përmirësimin e cilësisë së edukimit të fëmijëve. Godinat shkollore, përgjithësisht, janë të amortizuara dhe larg standardeve që ka përcaktuar shteti ynë për to. 90% e tyre nuk kanë banjë moderne për djem e për vajza, uji i pijshëm mungon në më shumë se 40 % të shkollave, më shumë se 45% e shkollave nuk kanë rrjet elektrik dhe asnjë shkollë nuk kanë linjë telefonike.

Është shtuar numri i shkollave që kanë biblioteka me literaturë të përshtatshme për edukimin e fëmijëve, nga 15% në 30%. Vetëm 10% e shkollave kanë palestra dhe terrene sportive në shërbim të mësimit të edukimit fizik dhe të zhvillimit të veprimtarive sportive, që fëmijët i duan shumë. Në 93% të shkollave mungojnë laboratorët bashkëkohorë për zhvillimin e lëndëve bazë shkencore.

3.3 E drejta për pjesëmarrje

Në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së nxënësve në veprimtaritë shkollore në përgjithësi dhe në vendimmarrjet e tyre në veçanti, në shkollat e Bashkise Tropoje janë shënuar hapa domethënës përpara. Shoqata ALPIN po ashtu dhe Partneret për Femije prej më se 15 vjetësh po zbaton projekte në mbrojtje të drejtave të femijeve, ky **projekt ka synuar ngritjen e një modeli për pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje**. Pothuajse në të gjitha shkollat ku është operuar qeveritë e nxënësve janë funksionale.

Me gjithë këto arritje zbatimi i projektit ka nxjerrë në pah mjaft probleme në terren pedagogjik tradicional që e vinte mësuesin në qendër, të mbetjeve të theksuara të patriarkalizmit në familje, të përvojës së paktë në lëmë të qeverive të nxënësve, ka hasur jo pak vështirësi, ka nxjerrë në pah mjaft probleme.

- Vendin e qeverisë së nxënësve në shkollë,
- Zgjedhje të lira dhe demokratike,
- Raportin e kësaj strukture të pavarur me drejtorinë e shkollës dhe organet e saj kolegjiale,
- objektin e punës së qeverive të nxënësve,
- vendin i koordinatorit etj.

Pas një pune të bërë në analizen e situatës në Bashkinë Tropoje dhe në gjitha njesitë administrative rezultoi mungesa e NJMF si strukture baze kjo strukture e bazuar në Ligjin Nr. 18 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Femijes. Gjithashtu ka munguar grupi teknik ndërsektorial dhe aktoret në menaxhimin rasti, ndaj për këtë ka qenë i vështirë identifikimi, referimi dhe menaxhimi i mbrojtjes së femijeve në Tropoje. Që në hartimin e projektit propozimit është vërejtur një problem i tillë pasi kërkonim të dhëna dhe nuk ishin të sakta. Gjithë kjo ardhur si rezultat i mos njohjes së ligjit dhe zbatimit të tij. Grupet ndërsektoriale kanë lobuar gjatë gjithë kohës për të hapur një zyrë për drejtat e femijeve në Bashkinë Tropoje. Gjithë Plani Lokal i Veprimtari që do hartohet do shërbejë bashkëveprim për ta shfrytëzuar për punën e saj në mbrojtje të drejtave të Femijeve.

Qëllimi 1: Zhvillim i sigurimit të arsimit cilësor për të gjithë fëmijët

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Baza e informacionit	Financimi	Monitorimi	Kostimi/Euro
Objektivi 1.1: Sigurimi i aksesit arsimor për të gjithë fëmijët							
1.1.1 Seanca ndërgjegjësimi në fshatrat e largëta për rëndësinë e ndjekjes së kopshtit.	Bashkia Tropoje Zyra e Arsimit Drejtoria e Shërbimeve Sociale /NJMF OJF-te, Administratoret Social, DAR, Bashkia Tropoje, Administratoret social, Drejtoria e Shërbimeve Sociale	<u>2018-2021</u>	1.1.1 50 % e fëmijëve 3-6 vjeç tërhiqen në kopshte.		<u>Bashkia dhe donator te ndryshem</u>	<u>DAR Kukes</u>	100000
1.1.2 Pajisja e kopshteve me mjetet mësimore didaktike baze për zhvillimin normal të aktiviteteve parashkollore			1.1.2 Numri i nxënësve e klasës së parë kanë ndjekur kopshtin 50%.				
1.1.3 Identifikimi dhe pajisja me libra e fëmijëve në nevojë sidomos fëmijët egjiptianë dhe ata me probleme sociale e familjare.			1.1.3 98 % e fëmijëve 6-vjeçare regjistrohen në klasën e parë. 1.1.4 Braktisja e shkollës reduktohet në 0.5 %, për vajzat 1%.				
Objektivi 1.2: Sigurimi i cilësisë së edukimit për të gjithë fëmijët							
1.2.1 Organizimi i takimeve mes bordit të shkollës, këshillave pedagogjik, qeverive të nxënësve për të adresuar problemet që shfaqin nxënësit në të nxene	DAR, MAS, OJF, DAR, MAS, Shkollat DAR, MAS, mësuesit	<u>2018-2021</u>	1.2.1 Analfabetizmi në popullatën shkollore 0 %.			<u>ZR Tropoje</u>	<u>5000</u>
1.2.2 Ndërgjegjësim dhe veprimtari për parandalimin e konsumimit të duhanit, alkoolit dhe drogës nga fëmijët			1.2.2 Nxënësit që nuk plotësojnë objektivat minimale të të nxënësve reduktohen në 10 %.				
Objektivi 1.3: Rritja e cilësisë së menaxhimit të sistemit arsimor, duke siguruar përfshirjen e strukturave të prindërve e të fëmijëve dhe qeverisjen vendore							
1.3.1 Organizimi i trajnimeve për përmirësimin e nivelit arsimor të mësuesve, sidomos në zonat rurale Integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjedisin dixhital, dhe pajisja e tyre me tableta	DAR, Sektori i Arsimit pranë Bashkisë, MAS, DAR, OJF Bashkia, MAS, DAR, Bashkia,	<u>2018-2021</u>	1.3.1 Reduktimi i numrit të nxënësve në klasa kolektive në 10 %. 1.3.2 Numri i nxënësve për 1 kompjuter nga 1/56 të shkojë në 1/10.			<u>ZR Tropoje</u> <u>ZR Tropoje</u>	<u>105000</u>

	DAR, Shkollat, OJF-te Projektet e Komisionit Evropian, Bashkia Tropoje, Shoqëria Civile		1.3.3 Rreth 160 fëmije me aftësi të kufizuara të Bashkisë Tropoje pajisen me tableta si mjete shkollore dhe kreative sipas konventës evropiane të Këshillit Evropës.				
--	---	--	--	--	--	--	--

Qëllimi 2: E drejta e mbrojtjes shoqërore dhe pjesëmarrjes/Integrimi i fëmijëve në nevojë

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Baza e informacionit	Financimi	Monitorimi	Kostimi/Euro
Objektivi 2.1 Integrimi i grupeve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje							
2.1.1 Identifikimi i grupeve të fëmijëve në nevojë për çdo klasë e shkollë dhe hartimi i programeve të punës së veçantë për integrimin e tyre në procesin mësimor-edukativ.	DAR, SHSSH, Bashkia	<u>2018-2021</u>	2.1.1 Është prodhuar një date-base i plotë për fëmijët në nevojë në Bashkinë Tropoje.			<u>SHSSH</u> <u>NJMF</u> <u>BASHKIA</u> <u>TROPOJE</u>	<u>34500</u>
2.1.2 Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave dhe ndërtimi i rampave. Sigurimi falas i mjeteve shkollore për fëmijët egjiptianë dhe fëmijëve me probleme shëndetësore e social-ekonomike.	Bashkia, DAR, OJF-te		2.1.2 Janë hartuar programe të përbashkëta të DAR dhe shkollave me qeverisjen vendore dhe shoqërinë civile për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të arsimimit dhe të integritit të fëmijëve në nevojë.				
2.1.3 Hartimi dhe zbatimi i programeve të veçanta për përmirësimin e ecuresë mësimore e edukative të fëmijëve në nevojë në shkollë e jashtë saj.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale ne Bashki, DAR, OJF		2.1.3 100 % e fëmijëve me nevoja të veçanta tërhiqen në shkollë.				
Objektivi 2.2 Rikthimi në shkollë i fëmijëve të identifikuar në rrezik braktisje dhe fëmijëve që janë kthyer nga vendet perëndimore që nuk kanë përfunduar arsimin bazë dhe ofrimin e alternativave për formimin profesional.							
2.2.1 Identifikimi i fëmijëve në risk referimi dhe zgjidhja e rasteve.	NJMF, Administratoret Social		2.2.1 Nr i fëmijëve që kanë përfunduar arsimin bazë si rezultat i rikthimit të tyre në shkollë.			<u>ZR Tropoje</u>	<u>200000</u>
2.2.2 Përmirësimi i protokollit të transferimit të nxënësve.	Grupi multidisiplinar në bashki		2.2.2 Nr i fëmijëve që SHSSH ndjekin arsimin profesional.			<u>SHSSH</u>	
2.2.3 Trajnimi i grupeve multidisiplinare në NJA dhe bashki.	DAR, Shkollat OJF-te, GIZ,		2.2.3 Nr i fëmijëve që aktivizohen në fushat e sportit dhe ato të lojërave të krijuara për këtë grup fëmijësh.				
2.2.4 Bashkëpunimi me zyrën e rajonale të punësimit për të siguruar ofrimin e kurseve profesionale për fëmijët që nuk ndjekin arsimin e mesëm.	ALPIN Zyra e punës, Bashki, Qendrat Profesionale						
2.2.5 Krijimi i fushave sportive dhe lojërave për fëmijët.							

Objektivi 2.3: Identifikimi i fëmijëve ne situatë rrugë të shfrytëzuar ekonomikisht si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet bazë të arsimit, shëndetësisë.							
2.3.1 Ngritja e grupit të punës në terren për identifikimin e fëmijëve dhe familjeve të shfrytëzuar ekonomikisht.	Grupi multidisiplinar në bashki DAR, Shkollat		2.3.1 Një grup pune ngrihet në nivel bashkie për të ndjekur problemin e fëmijëve në nevojë.			<u>Bashkia</u>	<u>200000</u>
2.3.2 Regjistrimi i fëmijëve të përgjithshëm në gjendjen civile dhe regjistrimi i tyre në qendrat shëndetësore dhe hapja e kartelave të shëndetit.	NJMF , Drejtoria e Shëndetit Parësor		2.3.2 Të gjithë fëmijët në nevojë regjistrohen dhe identifikohen në nivel bashkie.			<u>Drejtoria e shëndetit</u>	
2.3.3 Ofrimi i ndihmës emergjente shëndetësore dhe regjistrimi në shkollë ose kopshte parashkollore.	Zyra e punës, Bashki, Qendrat Profesionale		2.3.3 Fëmijët në nevojë u jepet ndihma shëndetësore nga Drejtoria e Shëndetit Parësor dhe Spitali Civil Tropoje.			<u>Kryqi i kuq</u>	
2.3.4 Ngritja e qendrave të strehimit të përkohshëm për familjet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje sipas përcaktimit të ligjit 18/2017.	Bashkia dhe Kryqi Kuq		2.3.4. Ngrihen 2 qendra të përkohshme banimi në zonën industriale, të rikonstruuar për familjet e fëmijëve në nevojë.				
			2.3.5. Bashkëpunohet me Kryqin e Kuq dhe Bashkinë për ofrimin e ndihmës konkrete për të gjithë fëmijët në nevojë.				

Qëllimi 3: E drejta e mbijetesës dhe kujdesit shëndetësor

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Baza e informacionit	Financimi	Monitorimi	Kostimi/Euro
Objektivi 3.1: Përmirësimi i higjienës në fëmijërinë e hershme/Përmirësimi i aksesit për gratë që jetojnë në zonat rurale							
<p>3.1.1 Rritja e cilësisë së shërbimit pediatri sidomos në zonat rurale</p> <p>3.1.2 Forcimi i kontrollit për infermieret dhe mamitë gjatë kujdesit për fëmijët e sapolindur</p> <p>3.1.3 Trajtimi i rasteve të rënda në spitalet e specializuara më të afërta.</p> <p>3.1.4 Përmirësimi i ushqyerjes së fëmijëve dhe organizimi i fushatave ndërgjegjësuese nga ana e drejtorisë së shëndetit publik në zonat rurale.</p> <p>3.1.5 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për rëndesinë e vaksinimit të fëmijëve.</p> <p>3.1.6 Sigurimi i ujit të rrjedhshëm dhe tualeteve në shkollat ku këto shërbimet që mungojnë</p> <p>3.1.7 Pajisja e spitalit rajonal me specialiste të fushave si neuropediater etj.</p> <p>3.1.8 Riorganizimi i shërbimeve dentare, mjekësore, dhe psikologjike në shkolla, përmes krijimit të shërbimeve multidisiplinore</p> <p>3.1.9 Organizimi në skuadra mobile me mjekë specialistë që bëjnë diagnostikimin e fëmijëve një herë në vit.</p> <p>3.1.10 Nxitja dhe hartimi politikave</p>	<p>DSHP, MSH,</p> <p>DSHP, MSH</p> <p>Spitali, Materniteti</p> <p>DSHP</p> <p>DSHP</p>	<p><u>2018-2021</u></p>	<p>3.1.1 Reduktimi në 0 i rasteve të sëmundjeve të formës së rëndë tek fëmijët e sapolindur.</p> <p>3.1.2. Për çdo fëmijë të lindur ka në dosjen e tij testet kryesore që tregojnë shenjat vitale të jetës.</p> <p>3.1.3 Nr i punonjësve të trajnuar.</p> <p>3.1.4 Është ulur numri i fëmijëve obezë.</p> <p>3.1.5 Shkollat janë të pajisura me shërbimet bazë të higjienës.</p> <p>3.1.6 Spitali rajonal ka kapacitete e duhura për trajtimin e sëmundjeve mendore për fëmijët.</p> <p>3.1.7 Shkollat ofrojnë shërbimin stomatologjik falas për fëmijët 0-18 vjeç.</p> <p>3.1.8 Fëmijët e zonave të thella malore përfitojnë vizita falas nga mjekë specialistë.</p> <p>3.1.9 Rritja e informacionit për citet që presin fëmijë për here të pare.</p>				<p><u>34500</u></p>

lokale mbështesë për shërbimin mjekësor (bursa, te drejta studimi)							
Objektivi 3.2: Përmirësimi i shëndetit të nënës dhe kujdesit antenatal							
